



Rr. Eduard Lir 158, Arbëria  
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: 038 22 22 55, 038 60 40 20  
Fax: 038 60 40 19  
Web: [www.tempulli.org](http://www.tempulli.org)  
Email: [info@tempulli.org](mailto:info@tempulli.org)

## **DORACAKU I STUDENTIT**

Prishtinë, 2023

## Përmbajtja

1.	Hyrje	2
2.	Fjala e Drejtorit të Akademisë	3
2.1.	Vizioni	4
2.2.	Misioni	4
2.3.	Vlerat dhe parimet	4
3.0	Regjistrimi në studime	5
3.1.	Statusi i studentit	5
3.2.	Studimet	6
3.3.	Lëndët mësimore	6
3.4.	Regjistrimi i lëndëve	6
3.5.	Pushimet për studentë	7
3.6.	Njohja e studimeve	7
3.7.	Ndërrimi i drejtimit të studimeve	7
3.8.	Mobiliteti i studentëve	8
3.9.	Ligjëratat (organizimi i mësimi)	8
3.10.	Kushtet për regjistrim në vitin vijues	8
3.11.	Përsëritja e vitit	9
3.12.	Puna praktike e studentëve	9
3.13.	Absolventët	9
3.14.	Ndërprerja e përkohshme e studimeve (suspendimi)	10
4.0.	Kontrolli dhe vlerësimi i dijeve	11
4.1.	Provimet	11
4.2.	Paraqitja e provimeve	12
4.3.	Realizimi i provimeve dhe mbikqyrja	13
4.4.	Shpallja dhe ndryshimi i notës	13
4.5.	Çertifikata e notave	13
4.6.	Humbja e statusit të studentit	13
4.7.	Të drejtat dhe obligimet e studentëve	14
4.8.	Organizimi i studentëve	15
4.9.	Studentët me bursë	16
4.10.	Biblioteka Universitare	16
4.11.	Shërbimi i Teknologjisë Informative	16
4.12.	Kartela për identifikim	16
4.13.	Pagesa e studentëve	17
4.14.	Përfitimet financiare	17
4.15.	Aktivitetet studentore	17
4.16.	Këshilli i etikës	18
4.17.	Ruajtja e pasurisë dhe ambientit në Akademinë Tempulli	18

## 1. Hyrje

Doracaku do të shërbejë si udhërrëfyes për studentë të Akademisë “Tempulli” dhe është i bazuar në:

- Ligjin mbi Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës
- Statutin e Akademisë “Tempulli”
- Rregulloren për Studimet Bachelor dhe Master në Akademi
- Rregulloren për transfer
- Rregulloren për mobilitet
- Kodin e Etikës, etj.

Përmbajtja e këtij doracaku është e saktë në kohën e botimit të tij. Informacionet mund të ndryshojnë varësisht rrethanave dhe zhvillimet evolutive të institucionit. Akademia “Tempulli” rezervon të drejtën që të përditësojë në vazhdimësi të dhënat. Për më shumë informata ose paqartësi vizitoni faqen tonë: [www.tempulli.org](http://www.tempulli.org)

## 2. Fjala e Drejtorit të Akademisë

Akademia Tempulli është regjistruar më 13 tetor 2020 si Institucion i Arsimit të Lartë në Kosovë. Akademia Tempulli, edhe pse një institucion mjaft i ri, ka një traditë të gjatë që nga viti 1992, dhe atë si qendër trajnimi dhe edukimi për studentët e rinj të drejtimit të automjeteve dhe si Kolegj Tempulli nga viti 2001 deri në vitin 2020. Si rezultat i angazhimit dhe nevojat e tregut, kjo qendër ka evoluar me kalimin e viteve dhe është rritur dhe zhvilluar me programe akademike dhe profesionale në kuadër të Akademisë Tempulli.

Si rezultat, duke marrë për bazë eksperiencën e gjatë në arsimin privat në Kosovë dhe duke u zhvilluar bashkë me Kosovën, si dhe duke rishikuar në mënyrë të vazhdueshme kërkesat për programe të reja, Akademia Tempulli ofron programe të reja cilësore.

Synimi dhe përkushtimi jonë i vetëm, si Institucion i Arsimit të Lartë në Kosovë është jo vetëm ofrimin e programeve të nevojshme por mbi të gjitha cilësore, të cilat në qendër kanë përgatitjen e studentëve për tregun e punës në sektorët e nevojshëm. Si rezultat, motivimi ynë kryesor jeni JU, studentë që keni zgjedhur Akademinë Tempulli për rrugëtimin tuaj akademik dhe profesional.

Ne do të punojmë që studentët tanë të udhëheqin dhe punojnë në tregun e punës në Kosovë e më gjerë; si dhe frytet e punës sonë, atë të rritjes së sigurisë në rrugë dhe sektor të tjerë. Ashtu si edhe Themeluesi i Akademisë “Tempulli” profesor Arif Krasniqi thoshte:

*”Trafiku është gjaku i sistemit ekonomik të çdo vendi por edhe i Kosovës dhe është bartësi kryesor i ndryshimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm të vendit tonë. Rrugët e qarkullimit të gjakut të këtij sistemi janë arteriet rrugore, hekurudhore, detare, postare dhe ajrore”.*

Ne si rezultat i punës sonë, jemi siguruar dhe besojmë se CILËSIA është çelësi dhe fokusi i punës sonë, prandaj ne e gjithë energjitë e punës sonë do orientojmë në ofrimin e programeve të krahasueshme me ato të Bashkimit evropian, programe me përmbajtje shkencore, arsimore e aftësuese.

## 2.1. Vizioni

Një institucion unik i arsimit të lartë në vend dhe rajon, me fokus zhvillimin e aftësive kërkimore profesionale nëpërmjet ndërlidhjes së mësimdhënies inovative, mësimi praktik dhe punës shkencore në dobi të komunitetit.

## 2.2. Misioni

Përgatitë në mënyrë cilësore studentët dhe kursantët me njohuri dhe aftësi adekuate për të mësuar dhe hulumtuar në mënyrë që të udhëheqin një karrierë të suksesshme profesionale dhe, së bashku me akademinë si dhe individualisht, të kontribuojnë me përgjegjësi për komunitetin.

## 2.3. Vlerat dhe parimet

- **Vlera:** Akademia ka një qasje ndaj të tjerëve, e cila reflektohet në mënyrën se si ata vlerësojnë kontributin e tyre. Akademia tregon respekt në të gjitha marrëdhëniet e saj me palët e interesuara, duke përfshirë marrëdhënien ndërmjet stafit drejtues dhe mënyrën se si komunikon me partnerët, financuesit dhe ofron shërbime për qytetarët;
- **Integriteti:** Akademia do të fitojë besim dhe respekt duke qenë profesionale, etike, e ndershme dhe e paanshme. Ndershmëria dhe sinqeriteti në të gjitha marrëdhëniet dhe komunikimet e Akademisë siguron që informacioni të jetë në kohë dhe i vërtetë;
- **Përfshirja:** Akademia është e përkushtuar ndaj diversitetit, barazisë së mundësive dhe drejtësisë sociale për të gjithë, duke vlerësuar dallimet dhe duke i mirëpritur ato;
- **Bashkëpunimi dhe partneriteti:** Akademia vlerëson partneritetin dhe bashkëpunimin si mënyrën më efektive për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve të saj, duke qenë e hapur për bashkëpunim akademik dhe shkencor, me institucionet publike dhe private, vendore dhe ndërkombëtare, në fusha dhe projekte me interes të përbashkët, gjithmonë. garantimi i shprehjes së lirë të ideve dhe ofrimi i mundësive të barabarta të stafit dhe studentëve për punë dhe studim;
- **Inovacioni:** Akademia është e hapur ndaj ndryshimit, përshtatjes, veprimit proaktiv dhe inovacionit në punën e saj të përbashkët për të gjetur metoda të reja për të përballuar sfidat në një mjedis gjithnjë në ndryshim;

- **Perfeksioni:** Akademia ka pritshmëri të mëdha për veten, studentët dhe komunitetet tona, prandaj synon të përmirësojë vazhdimisht cilësinë e shërbimeve të saj bazuar në parimin e Akademizmit, transparencës dhe pavarësisë.

### **3.0 Regjistrimi në studime**

Secili kandidat që ka kaluar provimin e maturës shtetërore, gëzon të drejtën për të konkurruar për regjistrim në studime në Akademinë “Tempulli”. Të drejtë konkurrimi kanë edhe kandidatët jo shtetas të Republikës së Kosovës.

Kriteret për pranim caktohen nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit si dhe Këshilli Akademik i Akademisë Tempulli. Mënyra e pranimit si dhe kriteret janë të rregulluara me rregulloret e studimeve në Akademi të cilat nxirren nga Këshilli Akademik i Akademisë.

### **3.1. Statusi i studentit**

Statusi i studentit fitohet me rastin e regjistrimit në programin e studimit dhe me rastin e nënshkrimit të Kontratës për studime në Akademinë Tempulli. Studentët mbajnë status të rregullt, meqenëse studime me korrespondencë nuk organizohen në institucionin tonë.

Të gjitha programet mësimore me të cilat funksionon Akademia, janë të akredituara nga Agjencia e Kosovës për Akreditim.

Nga programet e akredituara, në Akademinë Tempulli organizohen studime në dy nivele:

- studime themelore (bachelor) profesionale dhe shkencore dhe
- studime master.

Korniza Nacionale e Kualifikimeve cakton nivelin e kualifikimit për studentët tanë.

Studimet themelore (Bachelor) profesionale dhe shkencore zgjasin gjashtë semestra ose 3 vite. Çdo semestër duhet të ketë nga 30 ECTS kredi dhe me rastin e diplomimit studenti duhet të ketë të akumuluar 180 ECTS kredi. Studimet master zgjasin 4 semestra me 120 ECTS. Çdo semestër duhet të ketë së paku 30 kredi, ndërsa me rastin e diplomimit studenti duhet të ketë të grumbulluara 180 ECTS.

Studimet themelore (bachelor) janë nivel i VI-të ndërsa ai i studimeve master është niveli i VII-të. Studenti diplomon me mbrojtjen e punimit të tezës së diplomës aty ku kjo çështje është e përcaktuar në programin mësimor, ndërsa në raste të tjera kur këtë nuk e parasheh programi mësimor, studenti diplomon me dhënien e provimit të fundit. Pas kryerjes së studimeve fitohet thirrja “Bachelor” i programit përkatës, kurse me kryerjen e studimeve Master fitohet thirrja “Master i shkencave” varësisht prej emërimit të programit.

Studentët pajisen me CERTIFICATË të notave, DIPLOMË dhe më SHTOJCËN E DIPLOMËS.

### **3.2.Studimet**

Çdo program i studimit në Akademinë Tempulli realizohet përgjatë vitit akademik i cili është i organizuar në dy semestra. Ligjëratat në vitin akademik korrespondojnë me 1500 orë mësimi, ndërsa një ECTS kredi është e barabartë me 25 orë angazhim për studentin.

Semestri dimëror fillon me 01.10. të vitit aktual dhe zgjatë deri me 15 janar të vitit vijues (15 javë mësim), ndërsa semestri veror fillon prej 16. 02. të vitit vijues dhe zgjatë deri me 31. 05. të vitit vijues, po ashtu ( 15 javë mësim).

Vëllimi i ECTS kredive sipas Sistemit Evropian është 60 kredi për viti akademik.

### **3.3.Lëndët mësimore**

Studimet mbështeten në syllabuse të programeve mësimore të akredituara. Ato realizohen përmes lëndëve përgjatë vitit akademik dhe përveç atyre obligative, studenti ka të drejtën e zgjedhjes së lëndëve zgjedhore.

### **3.4.Regjistrimi i lëndëve**

Në Sistemin e Menaxhimit të Informatave (SEMS) në fillim të çdo viti akademik bëhet regjistrimi i lëndëve mësimore me bartësin e lëndës. Regjistrimi i lëndëve bëhet për çdo program mësimor.

### **3.5.Pushimet për studentë**

Pushimi vjetor për studentë planifikohet për periudhën korrik – gusht.

Po ashtu edhe pushimi javor, festat shtetërore dhe aktivitetet e ndryshme janë të parapara sipas akteve ligjore dhe vendimeve të organeve drejtuese të Akademisë Tempulli.

### **3.6.Njohja e studimeve**

Njohja e studimeve bëhet në pajtim me rregullat e Konventës së Lisbonës mbi Njohjen dhe në pajtim me rregulloret e veçanta të Ministrisë.

Akademia i pranon kualifikimet (titujt dhe diplomat) e institucioneve të licencuara vendore ose të huaja të arsimit të lartë të cilat nostrifikohen nga MASHTI sipas procedurave të njohjes në pajtim me Udhëzimin administrativ të MASHTI dhe në përputhje të dispozitave të Statutit të Akademisë Tempulli.

### **3.7.Ndërrimi i drejtimit të studimeve**

Studenti mund të bëjë ndërrimin e programit të studimit duke përfunduar mësimin në një program të studimit dhe duke filluar mësimin në një program tjetër të studimit në Akademi. Ndërrimi i programit të studimit mund të bëhet në mes programeve të studimit me qëllim të arritjes së nivelit të njëjtë të arsimit.

Gjatë ndërrimit të programit të studimit, studentit i lejohet legalisht të filloj programin e ri të studimit nëse së paku 50% e provimeve të tërësishme të programit janë të kaluara dhe përputhen me programin ku studentit dëshiron të kalojë.

Regjistrimi në programin e ri të studimeve lejohet më së paku në vitin e dytë të studimeve, ose më së miri në vitin e studimeve që vijon pas programit të vjetër të studimeve. Më gjerësisht , Rregullorja e transfer të ECTS-ve.



### **3.8.Mobiliteti i studentëve**

Mobiliteti në kuadër të programit Erasmus + i cili është i financuar nga Komisioni Evropian iu mundëson studentëve të cilët e kanë të kryer vitin e parë të studimeve bachelor të shkojnë në shkëmbim në ndonjërin prej universiteteve apo Kolegjeve me të cilin Akademia Tempulli paraprakisht ka shpallur konkurs në ueb faqen e Akademisë apo forma tjera të komunikimit në Akademi. Për studentë e regjistruar në studimet master kanë të drejtë të aplikojnë që nga semestri i parë i studimeve. Më gjerësisht, shih Rregulloren për Mobilitet të Akademisë Tempulli.

### **3.9.Ligjëratat (organizimi i mësimi)**

Ligjëratat dhe format tjera të mësimdhënies dëgjohen nga studentët duke iu përmbajtur syllabusit të lëndës. Studenti është i obliguar që të marr pjesë në ligjëratat të organizuara për çdo lëndë mësimore dhe të parapara me syllabus.

Evidenca dhe dëshmia e pjesëmarrjes së studentëve në ligjëratat bëhet përmes listës për vijueshmërinë e studentëve në ligjëratat nga vetë studentët dhe mësimdhënësi i lëndës.

### **3.10. Kushtet për regjistrim në vitin vijues**

Për të regjistruar vitin vijues të studimeve studentin duhet të ketë të përfunduar vitin në pajtim me programin e studimit. Përrjashtimisht kushti për regjistrim të vitit të dytë akademik mund të arrihet me minus dy provime të pa dhëna nga viti paraprak.

Viti i tretë mund të regjistrohet nga studentët nëse kanë të kryera të gjitha provimet e vitit të parë dhe me deri në minus dy provime të pa dhëna të vitit të dytë.

Këshilli Akademik mund të vendosë kushte dhe kritere të veçanta të kalueshmërisë respektivisht regjistrimit të vitit akademik.

Studentët e studimeve master, vitin e dytë mund ta regjistrojnë nëse kanë arritur të akumulojnë 50% të kredive të vitit të parë. Niveli maksimal i viteve të regjistruara është sa dyfishi i studimeve ose sa numrin i viteve të rregullta të studimit.

### **3.11. Përsëritja e vitit**

Studentët të cilët nuk kanë plotësuar kriteret që të bëjnë regjistrimin e vitit vijues, duhet që të bëjnë përsëritjen e vitit (ri-regjistrohen). Studentët regjistrohen në programin e njëjtë të studimit ose me programe të ndryshuara i cili ofrohet për atë vit të studimit. Numri maksimal i viteve të regjistruara serish është i barabartë me numrin e viteve të rregullta të viteve të studimeve përkatës. Lejohet vetëm një ri regjistrim i një viti dhe nuk mund të ri-regjistrohet një vit akademik dy herë radhazi.

Nëse studenti nuk parashtron kërkesë për ri-regjistrim të vitit studimor, konsiderohet ndërprerje e studimeve më gjerësisht Rregullorja për studime themelor dhe Master.

### **3.12. Puna praktike e studentëve**

Për qëllim të aftësimit profesional të studentëve dhe orientimit në Karrierë, Akademia në programe specifike organizon punën praktike të studentëve. Realizimi i punës praktike bëhet në kompani, Institucione apo Organizata të ndryshme me të cilat Akademia ka të nënshkruara Marrëveshje bashkëpunimi. Për studentë përkujdesen mësimdhënësit e lëndës dhe menaxherët e kompanive ku ata bëjnë praktikën. Nga kompania/institucioni/organizata jepet vlerësim për arritjen e realizuar, i cili vlerësim ndikon në notën përfundimtare të lëndës për të cilën studenti ka bërë mësimin praktik, apo në vlerësim me ECTS- në rastet e parapara në program.

Organizimi i punës praktike bëhet në bazë të rregullores për realizim të punës praktike për studentë të Akademisë Tempulli.

### **3.13. Absolventët**

Pas mbarimit të ligjëratave të vitit të fundit të studimeve, studentit i mundësohet periudha prej dy viteve akademike për të përfunduar të gjitha provimet. Gjatë kësaj kohe studenti duhet të jep provimin e diplomës që t'i përfundojë me sukses studimet. Gjatë kësaj periudhe studenti mban statusin e absolventit.

Studenti që ka tejkaluar kohen e paraparë për të përfunduar me sukses diplomën, mund të paraqesë kërkesë tek shërbimi për diplomim në kuadër të Administratës, për zgjatjen e kësaj periudhe vetëm edhe për një vit akademik.

Absolventët janë të obliguar të bëjnë përsëritjen e vitit. Për me shumë informacione, ju lutemi referohuni statutit dhe rregulloren për studime themelore dhe master në Akademi.

#### **3.14. Ndërprerja e përkohshme e studimeve (suspendimi)**

Studenti mund t'i ndërpres studimet në kohë të caktuar për një vit akademik, me kërkesë të ushtruar dhe të arsyetuar me dokumentacion përkatës. Periudha e pezullimit duhet të fillojë në fillim të vitit akademik, me kusht që studenti ti kryejë të gjitha obligimet ndaj institucionit.

Kohëzgjatja e përkohshme e pezullimit nuk llogaritet në kohën e studimeve.

Pas përfundimit të afatit suspendues, studenti është i obliguar që të rikthehet në studime me të gjitha të drejtat dhe detyrimet. Për më shumë informacione, ju lutemi referohuni Statutit të Akademisë Tempulli.

#### **4.0.Kontrolli dhe vlerësimi i dijeve**

Në Akademinë Tempulli vlerësimi i dijës bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe me metoda të ndryshme. Qëllimi është konstatimi i punës së studentit për të arritur dhe ruajtur cilësinë e dijes. Këto veprime ndërmerren në përputhje me syllabuset e lëndëve përkatëse. Gjatë vlerësimit të studentit merren për bazë, vijueshmëria, aktivitetet gjatë zhvillimit të mësimin në ligjërata, kollokiumet, prezantimet, detyrat puna praktike dhe provimi final.

Studentëve iu jepet mundësia e vlerësimit të stafit akademik dhe je akademik lidhur me arritshmërinë e kryerjes së punëve, komunikimi i tyre me studentë, angazhimi dhe përkushtimi i mësimdhënësit në mësim. Format e vlerësimit bëhen përmes formularëve të vlerësimit dhe janë anonim.

#### **4.1. Provimet**

Provimet mund të organizohen veç e veç për çdo lëndë mësimore ose të kombinohen për më shumë lëndë në pajtim me programin e studimeve (provim me komision).

Në fund të çdo semestri, pas përfundimit të procesit mësimor, organizohet sesioni i provimeve.

Provimet zhvillohen në tre afate:

- Afati i të dimrit, i cili zhvillohet në fund të semestrit të parë.
- Afati i verës, i cili zhvillohet në fund të semestrit të dytë.
- Afati i vjeshtës, i cili zhvillohet në muajin shtator.

Studentëve mund t'iu lejohen edhe afate të jashtëzakonshme (shtesë), me vendim të Këshillit Akademik.

Provimet janë publike dhe mbahen në këto mënyra:

- Me shkrim;
- Me gojë;
- Me shkrim dhe me gojë;
- Praktikë.

Provimet mund të mbahen nga një komision për provime në këto raste, nëse:

- studentit ankohej,
- është caktuar me program të studimeve.

Mënyra e përcaktimit të dijës dhe të dhënies së provimit përcaktohen me programin mësimor të lëndës. Mësimdhënësi i autorizuar i shënon notat në SEMS. Për më shumë shih: **Udhëzuesin e përdorimit të Sistemit të Menaxhimit të Informatave SEMS.**

NOTA	ECTS NOTA	PIKËT	PËRKUFIZIMI
10	A	90-100	SHKËLQYESHËM/EXCELLENT
9	B	80-89	SHUMË MIRË/VERY GOOD
8	C	70-79	MIRË/GOOD
7	D	60-69	KËNAQSHËM/SATISFACTORY
6	E	50-59	MJAFTON/SUFFICIENT
5	F	0-49	DOBËT/ POOR

#### 4.2. Paraqitja e provimeve

Paraqitja e provimeve bëhet në bazë të orarit, i cili duhet të jetë i publikuar në fillim të vitit akademik. Orari i provimit duhet të përcaktohet në atë mënyrë që studentit mos të ketë me shumë se një provim në ditë.

Koha e paraqitjes së provimit, orari i provimeve, tërheqja nga provimi ose mungesa e studentit, hyrja më herët në provim, pranimi i provimeve me rastin e transferimit dhe mobilitetit si dhe çështjeve të tjera lidhur me provime janë të rregulluar më përafërsisht me nenin 30 të Statutit të Akademisë dhe Rregulloret për Studime në Akademi.

Provimi me shkrim nuk mund të zgjasë më shumë se tri orë, ndërsa ai me gojë varet nga natyra e lëndës.

Provimi mund të mbahet edhe në kohë tjetër me kërkesë të justifikuar nga studentët apo mësimdhënësi i lëndës.

### **4.3. Realizimi i provimeve dhe mbikqyrja**

Është përgjegjësi e mësimdhënësit të lëndës që të organizojë dhe realizojë mbajtjen e provimit. Të gjithë anëtarët e stafit akademik janë të obliguar që sa më shumë të përkujdesen për krijimin e kushteve të favorshme në mënyrë që studentët të jenë më të suksesshëm në provim, duke u krijuar hapësira komode dhe duke mbajtur rendin dhe qetësinë gjatë mbajtjes së provimit.

### **4.4. Shpallja dhe ndryshimi i notës**

Pas mbajtjes së provimit, mësimdhënësi i lëndës në afat prej 48 orësh, bënë vendosjen e notës në SEMS.

Për çështje të tjera rreth realizimit të të drejtave dhe obligimeve që ka studenti, më detajisht janë të rregulluara më Rregulloren për studimet themelore dhe master.

### **4.5. Certifikata e notave**

Pas kryerjes së provimit, notat e studentëve regjistrohen nga Shërbimi i Studentëve. Ndërsa sipas kërkesave të studentëve shërbimi studentor bënë lëshimin e tyre. Studentët mund të kenë qasje në sistem vetëm për shikim të notës e jo edhe të shërbehet me të, për shkak të mungesës së nënshkrimit nga personi adekuat dhe vulosja e saj nga zyrtari përkatës. Studenti duhet që personalisht të bëjë kërkesë për pajisje me Certifikatë të notave.

### **4.6. Humbja e statusit të studentit**

Studenti humb statusin për këto arsye:

- kur vendos të largohet nga studimet;
- kur i ka përfunduar studimet;
- kur dështon të regjistrohet në vitin akademik;

- kur nuk i ka përfunduar studimet në kohën e dyfishtë të kohëzgjatjes së studimeve;
- kur arrin numrin maksimal të regjistrimit të serishëm të viteve pa i përfunduar me sukses studimet;
- në rastin e përjashtimit, në bazë të vendimit të nxjerrë pas procedurës disiplinore.

Studenti mund të kërkojë njëherë t'i vazhdohet kohëzgjatja e studimeve për një apo dy vite. Vendimin e merr Këshilli Akademik. Shih Statutin e Akademisë Tempulli.

#### **4.7. Të drejtat dhe obligimet e studentëve**

Studentët që janë pranuar në Akademinë Tempulli kanë të drejtë:

- Të marrin pjesë në ligjërata, seminare, ushtrime teorike, ushtrime praktike laboratorike dhe në teren, mobilitete, hulumtime, diskutime, konsultime profesionale dhe format tjera të mësimi sipas plan-programit në fuqi;
- Të shfrytëzojnë bibliotekën e Akademisë, hapësirën fizike dhe pajisjet tjera teknike si internetin, laboratorët, kompjuterët.
- Të marrin pjesë në zgjedhjet për përfaqësuesit e studentëve në organet përfaqësuese të Akademisë dhe të studentit, si dhe të marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e organeve dhe komisioneve ku janë caktuar si anëtarë dhe t'i kryejnë detyrat e besuara në organet e Akademisë;
- Të marrin pjesë në aktivitetet kulturore e sportive, seminare profesionale, konferenca dhe tubime të studentëve;
- Të marrin pjesë në konkurs për çmimin student i dalluar dhe bursist i Akademisë si dhe të drejta të ndërlidhura me to, që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen aktive dhe kritike të studentit.

Studentët këto detyra duhet t'i kryejnë me angazhim dhe në mënyrë të sinqertë. Me rastin e paraqitjeve të ideve të reja dhe opinioneve nuk rrezikojnë e vendit të studentit apo privilegje të tjera të përcaktuara në Statut dhe rregullore.

Kanë të drejtë të ankohen në lidhje me cilësinë e procesit të mësimdhënies ose infrastrukturë e Akademisë si dhe gëzojnë të drejtën për të kundërshtuar një vendim apo veprim të Akademisë pranë organeve kompetente.

Studentët kanë për detyrim:

- t'i zbatojnë rregullat e përcaktuara nga Akademia;
- t'i respektojnë të drejtat e personelit dhe studentëve të tjerë;
- t'u kushtojnë vëmendje të duhur studimeve të tyre dhe të marrin pjesë në aktivitetet akademike;
- Të vijnë ligjëratat në pajtim me rregullat e programit specifike të studimeve;
- Të tregojnë kulturë njerëzore dhe akademike në lokalet e Akademisë ashtu edhe jashtë tyre për të mos e diskredituar Akademinë.

Më përparësisht çështjet e të drejtave dhe obligimeve të studentëve rregullohen në nenin 28 të Statutit të Akademisë Tempulli.

#### **4.8. Organizimi i studentëve**

Në përcaktimin e numrit të përgjithshëm të studentëve në Këshill Akademik mbahen në konsideratë praktikatat më të mira për përfaqësimin në masën 15% të studentëve dhe 5% të personelit jo akademik; si dhe 25% në organizimin e përgjithshëm të Akademisë.

Studentët kanë të drejtë të themelojnë organizata studentore të cilëve mund t'iu përkasin të gjithë studentët.

Secila organizatë studentore ka statutin e vet që aprovohet nga anëtarët e saj në pajtim me rregullore të përgjithshme të nxjerrë nga Këshilli Drejtues.

Statuti duhet të përfshijë parimet për mundësi të barabarta dhe mos diskriminim.

Interesat e studentëve përfaqësohen në Këshillin e studentëve.

Anëtarët e Parlamentit studentor zgjidhen në pajtim me Rregulloren për Këshillin e studentëve.



#### **4.9. Studentët me bursë**

Akademia Tempulli ofron bursa studimi për studentët më të mirë si formë stimulimi dhe ndikimi në arritje të cilësisë më të madhe të mësimi. Përfitues të bursës studentore mund të jenë të gjithë studentë të cilët plotësojnë kriteret të cilat Rregullorja për ndarjen e bursave.

#### **4.10. Biblioteka Universitare**

Akademia ka një bibliotekë të pajisur me tituj të ndryshëm shkencor dhe hulumtues e cila është në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik.

Studentët mund të kenë qasje me literaturë dhe teza të diplomave të nevojshme për studime ku studentët mund t'i huazojnë por edhe të shërbehen duke shfrytëzuar lokalet për lexim.

Qëllimi i ynë është që biblioteka në vazhdimësi të pajiset me literaturë bashkëkohore dhe tituj shkencor e hulumtues që do t'i hyjnë në përdorim studentëve.

#### **4.11. Shërbimi i Teknologjisë Informative**

Teknologjia Informatike ka një rol të rëndësishëm por është në fazën fillestare të aplikimit të saj. Studentët mund të marrin shërbime dhe informacione tek Zyrtari i Teknologjisë Informative lidhur me gjërat e përditësuara për studentë.

#### **4.12. Kartela për identifikim**

Çdo studentë i Akademisë duhet të pajiset me ID kartelë pas regjistrimit në studime përmes së cilës identifikohet statusi i tij.

#### **4.13. Pagesa e studentëve**

Në studimet themelore (bachelor), studentët paguajnë 1260 euro për vit/ për semestër 630 E. Në studimet master studentët paguajnë: viti i I-rë 1500 €, respektivisht nga 750€ për semestër dhe 750€ për regjistrim të semestrit të II-të, 750 për semeser III-të dhe për 750 për semestër të IV-tët dhe për mbrojtje të punimit të diplomës 400.

Paraqitja e provimeve në studimet bachelor është 10 Euro dhe master paguhet 20€.

#### **4.14. Përfitimet financiare**

Motivimit të studentëve për të arritur rezultate sa më të mira në mësim nxënie, Akademia jep një përkushtim të veçantë.

Ky stimulim manifestohet përmes vizitave studimore të studentëve për aftësim profesional të tyre, pastaj përkrahje të projekteve studentore, bursave studentore si dhe ndarja e çmimit të studentit të dalluar.

#### **4.15. Aktivitetet studentore**

Përmes Këshillit të Studentëve, studentët shprehin mendime dhe propozime për të gjitha kërkesat dhe aktivitetet jashtëshkollore për student si: *aktivitetet në projekte të cilat shprehin mundësin e promovimit të kulturës së ngasjes së rrugë në komunitet, marrje pjesë në vizita të qyteteve në formë ekskursioni, në aktivitete humanitare, garave, pjesëmarrje në debate, absolventiatave, aktivitete informuese.* Të gjitha këto janë të garantuara dhe aplikohen përmes rregullores së Qendrës së Karrierës së Akademisë dhe faqeve studentore online të cilat shërbejnë si mundësi e mirë e rrjetëzimit, komunikimit dhe organizimit në aktivitete të përbashkëta.

#### **4.16. Këshilli i etikës**

Është organ vendimmarrës i cili promovon dhe mbron vlerat pozitive në mes stafit akademik dhe jo akademik. Detyrë parësore e tij është shqyrtimi i sjelljes së personelit në tërësi në rastet e shkeljes së etikës e po ashti edhe të sjelljeve të studentëve gjatë studimeve. Më gjerësisht shiko Kodin e Etikës, në ueb apo pranë Këshillit të studentëve.

#### **4.17. Ruajtja e pasurisë dhe ambientit në Akademinë Tempulli**

Çdo i punësuar, nga stafi akademik, jo akademik dhe ai ndihmës si dhe studentët janë të obliguar që të sillen mire në lokalet e Akademisë dhe të ruajnë pasurinë e tij. Kujdesi duhet të përkushtohet në ruajtjen e inventarit, si dhe pastërtisë. Po ashtu kujdes i veçantë duhet t'i përkushtohet hapësirave të jashtme të cilat i posedon Akademia.

Në lokalet e brendshme të Akademisë, rreptësishtë ndalohet pirja e duhanit, ndërsa pirja e alkoolit dhe konsumimi i substancave narkotike assesi nuk lejohet dhe do të sanksionohet me dispozita nënligjore e ligjore.